



Funded by
the European Union

Ndikimi i tërheqjes së kursimeve pensionale deri në 30% në ekonominë e Kosovës



Qershor 2022

KOSOVO 2.0

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

Ndikimi i tërheqjes së kursimeve pensionale deri në 30% në ekonominë e Kosovës

Qershor 2022

Deklaratë mohimi:

Ky publikim është botuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe Kosovo 2.0 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

— Përmbajtja

Të gjeturat kryesore	3
Hyrje	4
Ndikimi ekonomik i tërheqjes së mjeteve nga Trusti	4
Përfundim	9



Funded by
the European Union

KOSOVO 2.0

gap INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE

Të gjeturat kryesore:

- Kuvendi i Kosovës ka në procedurë shqyrtimin e Projektligjit i cili parasheh tërheqjen e deri 30% të kursimeve pensionale;
- Në rast se aprovohet ky ligj, Trusti obligohet që të fillojë procedurat për shpërndarjen e deri 594 milionë eurove, apo afër çerekun e mjeteve nën menaxhim të Trustit;
- Ligji do ua mundësonte tërheqjen e kursimeve 695,523 kontributdhënësve;
- Afër gjysma e kontributdhënësve (48.6%) pritet të tërheqin mesatarisht nga 96.5 euro.
- Vlera mesatare e kursimeve të një kontributdhënësi/e në Trust është 5,400 euro. Në rast të tërheqjes së parakohshme të kursimeve, rikuperimi i mjeteve do të merrte 8 vite kohë, si dhe shterrja e kursimeve pensionale në moshën e pensionimit do të shkurtohej për 2.2 vite;
- 90.4% e të gjithë kontributdhënësve do të mund të tërheqin 58% (345.8 milionë euro) të fondit prej 594 milionë euro, kurse pjesa tjetër prej 9.6% do të mund të tërheqin 42% (248.3 milionë euro) të gjithsej fondit maksimal të tërheqjes;
- Tërheqja e mjeteve do ua pamundësonte qytetarëve që në të ardhmen të blejnë edhe anuitetin e jetës, një mundësi ku përmes pagesës së një premium, kontributdhënësit do të mund të pranonin një pension gjatë tërë jetës pas pensionimit. Shuma e nevojshme e kursyer e një kontributdhënësi/e për të blerë një anuitet minimal do të duhej të ishte rreth 25 mijë euro në kohën e pensionimit;
- Injektimi i 594 milionë eurove në treg do të rëndonte edhe më tej situatën me çmime. Nëse e krahasojmë shumën e propozuar për tërheqje me peshën në konsumin familjar gjatë vitit 2021, injektimi i mbi 594 milionë eurove paraqet një potencial për rritje të konsumit prej mbi 9.2%;
- Rënia në tregjet ndërkombëtare ka bërë që të bie edhe çmimi për njësi i aksioneve të Trustit. Aktualisht Trusti ka vlerë rreth 102 milionë euro më pak së në fundin e vitit 2021;
- Tërheqjet e shpeshta nga Trusti do të dëmtonin kredibilitetin e Trustit në tregjet financiare, çka mund të bëhet më e vështirë që Trusti të performojë mirë në të ardhmen;
- Projektligji i 2022 nuk parasheh rimbursim të mjeteve të tërhequra.

Hyrje

Në Kuvendin e Kosovës ka hyrë në procedurë shqyrtimi i Projektligjit¹ i cili parasheh tërheqjen e parakohshme e deri të 30% të kursimeve pensionale. Projektligji i inicuar nga dhjetë deputetë të grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK)² dhe i mbështetur nga grupet tjera parlamentare në opozitë, i është shpërndarë deputetëve në fillim të muajit mars të 2022. Konform procedurave, më 23 mars 2022, Projektligji është dërguar në Qeveri për marrjen e opinionit. Në mbledhjen e Qeverisë të datës 21 prill 2022, Qeveria ka bërë të ditur mendimin e saj refuzues sa i përket nismës ligjore për tërheqjen e deri 30% të shumës së kursimeve pensionale.³

Projektligji nuk ka marrë votat e nevojshme as në mbledhjen e Komisionit parlamentar për buxhet dhe financa të mbajtur më 25 maj 2022. Projektligji pritet të dalë në lexim të parë në seancat e radhës së Kuvendit të Kosovës.

Kjo nuk është nisma e parë ligjore për tërheqjen e hershme të kursimeve pensionale. Për shkak të krizës ekonomike të shkaktuar nga masat kufizuese për menaxhimin e pandemisë COVID-19, me propozim të Qeverisë së Kosovës, në fund të vitit 2020, Kuvendi i Kosovës kishte aprovuar ligjin i cili ua mundësonte qytetarëve tërheqjen e 10% të kursimeve të tyre pensionale.⁴ Gjatë dhjetorit të vitit 2020 e deri më 6 prill 2021, kur ishte afati i fundit për tërheqjen e kursimeve, aplikuan 427,363 kontributdhënës, duke tërhequr 198 milionë euro.⁵

Para aprovimit të ligjit për tërheqjen e parë të kursimeve në vitin 2020, Instituti GAP kishte tërhequr vërejtjen se lejimi i njëhershëm i tërheqjes së parakohshme të kursimeve pensionale mund të shndërrohet në precedent për kërkesa të tilla edhe në rast të krizave të ardhshme, kësisoj, duke rrezikuar sigurinë financiare të qytetarëve kur të arrijnë moshën e pensionimit.⁶

Në këtë raport të shkurtër, Instituti GAP analizon ndikimin që mund të ketë aprovimi i këtij projektligji në kursimet e qytetarëve në Trust, ekonomi dhe funksionimin e Trustit.

Ndikimi ekonomik i tërheqjes së mjeteve nga Trusti

Rritja e çmimeve në treg si pasojë e moszgjidhjes së nyjave të krijuara në zinxhirin e furnizimit për shkak të pandemisë COVID-19 si dhe nga lufta në Ukrainë, ka rënduar situatën ekonomike të një pjese të shoqërisë në Kosovë. Lidhur me këtë situatë, Qeveria e Kosovës ka prezantuar disa masa që synojnë të ndihmojnë kryesisht qytetarët në nevojë, sikurse ata në Skemën e Ndihmës Sociale, pensionistët, studentët dhe të punësuarit me paga deri në 1.000 euro.⁷

Ndërkaq, përmes një nisme tjetër, partitë opozitare po synojnë të shtyejnë përpara propozimin që qytetarëve t'u lejohet tërheqja deri në 30% të mjeteve nga Fondi i Kursimeve Pensionale (Trusti).

1 Kuvendi i Kosovës. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L-115, me ligjin 04/L-168 dhe ligjin nr. 05/L116. Burimi: <https://bit.ly/3yQp3h7>

2 Kuvendi i Kosovës. Shkresa përcjellëse e Projektligjit. Burimi: <https://bit.ly/39WdlBy>

3 Qeveria e Kosovës. Vendimi nr.01/70, i datës 21 prill 2022. Burimi: <https://bit.ly/3sZxyxy>

4 Gazeta Zyrtare. Ligji nr.07/L-016 për rimëkëmbjen ekonomike-covid 19. Dhjetor 2020. Burimi: <https://bit.ly/3LQASqV>

5 Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës. Trustorja-buletini tremujor nr.53. Burimi: <https://bit.ly/3PHLdlq>

6 Instituti GAP. Dilema 10% – përfitime dhe dëmet nga tërheqja e parakohshme e kursimeve pensionale. Korrik 2021. Burimi: <https://bit.ly/3wM35u6>

7 Zyra e Kryeministrit. Burimi: <https://bit.ly/3sUGskY>

Projektligji parasheh mundësinë e tërheqjes së kursimeve në shumën nga 10 deri 30%, varësisht nga shuma e mjeteve të kursyera:

- Personat që kanë kursime pensionale në shumën më pak se 10,000 euro, kanë të drejtë t'i tërheqin deri në 30% të kursimeve të tyre pensionale;
- Personat që kanë kursime pensionale në shumën prej 10,000 euro deri në 19,999 Euro, kanë të drejtë t'i tërheqin deri në 25% të kursimeve të tyre pensionale;
- Personat që kanë kursime pensionale në shumën prej 20,000 euro deri në 29,999 euro, kanë të drejtë t'i tërheqin deri në 20% të kursimeve të tyre pensionale;
- Personat që kanë kursime pensionale në shumën prej 30,000 euro deri në 39,999 Euro, kanë të drejtë t'i tërheqin deri në 15% të kursimeve të tyre pensionale.
- Personat që kanë kursime pensionale me shumë se 40,000 euro, kanë të drejtë t'i tërheqin deri në 10% të kursimeve të tyre pensionale.⁸

Për dallim nga tërheqja e parë e vitit 2020, ku qytetarët që kishin më pak se 9,999 euro të kursyera në Trust do kenë mundësinë që paratë që tërheqin t'u kompensohen nga shteti, Projektligji i 2022 nuk parasheh rimbursim të mjeteve të tërhequra.

Projektligji i propozuar prek rreth 594 milionë euro të kursimeve të mbi 695 mijë kontributdhënësve në Trust. Mbi 90% të kontributdhënësve të cilët kanë mjete të kursyera në Trust kanë gjendje të kursimeve në vlerë më të ulët se 10 mijë euro. Nga ta rreth 337 mijë qytetarë do të mund të tërheqin mesatarisht nga 96.5 euro, meqë gjithsej kursimet e tyre nuk i arrijnë as 1,000 euro.

Tabela 1. Të dhëna rreth mjeteve në Trustin pensional, 2022

Shuma e kursimeve (€)	Vlera maksimale e tërheqjes	Nr.i kontribuesve aktiv	Vlera totale e kursimeve (€)	Vlera e tërheqjes maksimale (€)	Vlera e tërheqjes maksimale (%)	Numri i kontributdhënësve si %
1 – 10,000	30%	628,616	1,152,846,000	345,853,800	58%	90.4%
10,001 – 20,000	25%	51,210	676,503,000	169,125,750	28%	7.4%
20,001 – 30,000	20%	9,385	226,889,000	45,377,800	8%	1.3%
30,001 – 40,000	15%	3,609	123,817,000	18,572,550	3%	0.5%
Mbi 40,000	10%	2,700	152,531,000	15,253,100	3%	0.4%
Totali		695,523	2,332,586,000	594,183,000		

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Trustit


Në rast se lejohet tërheqja e mjeteve nga Trusti, qytetarët të cilët kanë më pak se 10 mijë euro të kursyera mbesin me bilanc tejet të ulët të kursimeve. Meqë Projektligji nuk parasheh një rritje të normës së kontributeve nga të punësuarit, sikurse nga 5 në 10%, në mënyrë që t'i rikuperojnë këto mjete më shpejtë, një bilanc i ulët ka efekte negative të shumëfishta për kontributdhënësit.

⁸ Kuvendi i Kosovës. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 04/l-101 për fondet pensionale të kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/l-115, me ligjin 04/l-168 dhe ligjin nr. 05/l116. Burimi: <https://bit.ly/3yQp3h7>

Vlera mesatare e kursimeve të një kontributdhënësi në Trust është 5,400 euro. Në rast të tërheqjes së mjeteve, me 5% kontribute pensionale mujore nga punëmarrësi dhe punëdhënësi, bilanci pas tërheqjes së mjeteve do të mund të rikuperohej vetëm pas tetë viteve, kurse në kohën e pensionimit do t'i shpenzonte kursimet e mbledhura për 2.2 vite më herët se në rastin kur nuk do të mundësohej tërheqja e mjeteve nga Trusti.

Një ulje e bilancit të kursimeve, në masë të ndjeshme sikur kjo që synohet me këtë Projektligj, ndikon në pamundësinë e qytetarëve që në të ardhmen të mund të blejnë dhe produkte sikurse anuiteti i jetës, ku duke paguar një premium ndaj një kompanie të sigurimit nga kursimet e mbledhura në Trustin pensional, një qytetar/e do të mund të marrë një pension përgjatë tërë jetës. Sipas raportit të Trustit për vitin 2020, shuma e nevojshme e kursyer e një kontributdhënësi për të blerë një anuitet minimal do të duhej të ishte rreth 25 mijë euro në kohën e pensionimit.⁹ Tek personat e moshës 40 vjeçare, të cilët kanë kursime më të larta në Trust aktualisht, sikurse 15 mijë euro apo më lartë, një shumë e tillë do të arrihej lehtë deri në kohën e pensionimit të tyre edhe sikur t'i tërhiqnin tani deri në 30% të mjeteve; siç tregon figura më poshtë. Pra, dëmi më i madh shkaktohet tek personat me më pak kursime në Trust, që janë kryesisht të rinjë të sapo futur në tregun e punës apo persona me të hyra më të ulëta.

Figura 1. Ndryshimet në bilancin e disa llogarive të një kontributdhënësi/je 40 vjeçar/e në kohën e pensionimit me dhe pa tërheqje të mjeteve nga Trusti



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Trustit

Një nga problemet tjera të tërheqjes së 594 milionë eurove nga Trusti është ndikimi i futjes së tyre në ekonomi. Që nga viti 2021, si rrjedhojë e pandemisë COVID-19, ku ishin shkaktuar shumë probleme në zinxhirin e furnizimit dhe prodhimit, por dhe goditje tjera në anën e ofertës sikurse nga lufta në Ukrainë, rritja e çmimeve në treg ka qenë mjaft e theksuar. Duke qenë se Kosova është neto importuese e produkteve të cilat kanë pësuar rritje të ndjeshme të çmimit, sikurse energjia elektrike, gruri, nafta etj., zhvillimet në tregjet ndërkombëtare pasqyrohen drejtpërdrejtë edhe në ekonominë e vendit tonë. Kjo rritje e çmimeve po vazhdon edhe më tej, ku vetëm në muajin prill 2022, çmimet në Kosovë ishin për 11.2% më të larta se në periudhën e njëjtë të vitit 2021.¹⁰ Furnizimi me produkte bazike parashikohet të ketë vështirësi edhe në periudhën afatmesme, siç paralajmëron Agjencia e Ushqimit dhe Bujqësisë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (FAO) në një raport të saj.¹¹


⁹ Trusti: Raporti vjetor 2020. Burimi: <https://bit.ly/3tifMuP>

¹⁰ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Prill 2022. Burimi: <https://bit.ly/3NwHxqQ>

¹¹ Food and Agriculture Organization. Burimi: <https://bit.ly/3xpLf8>

Rritja e kërkesës në treg veçse do të rëndonte situatën me çmime. Nëse e krahasojmë shumën e propozuar për tërheqje me konsumin familjar gjatë vitit 2021, injektimi i mbi 594 milionë eurove paraqet një potencial për rritje të konsumit prej mbi 9.2%.¹² Fillimisht, në mikroekonomi dihet se kërkesa për produkte bazike, sikurse buka (produkt i grurit, misrit etj.) dhe të ngjashme, është jo-elastike¹³ apo e ndjeshme në raport me ndryshimet në çmim; pasi që edhe mundësia për zëvendësim të tyre me produkte të ngjashme është e vogël.¹⁴ Për më shumë, siç gjen një raport tjetër i Institutit GAP mbi ndikimin e luftës në Ukrainë në ekonominë e Kosovës, kërkesa për produkte sikurse ato të naftës del të jetë jo-elastike pavarësisht rritjes së madhe të çmimit të naftës në Kosovë. Pra, përkundër që çmimi i naftës ishte rritur për rreth 89% në periudhën janar-mars 2022 krahasuar me periudhën e njëjtë të 2021, sasia e konsumuar kishte mbetur e njëjtë.¹⁵

Figura 2. Kërkesa për dizel dhe benzin në Kosovë, janar-mars 2021–2022



Burimi: Instituti GAP bazuar në të dhëna të Doganës.

Një situatë e ngjashme e ndikimit në rritje të çmimeve është vërejtur dhe në shtetin e Kilit, ku po ashtu është lejuar tërheqja e mjeteve për tre herë radhazi. Një raport i Federatës Ndërkombëtare të Administruesve të Fondit Pensional (FIAP) në Kili, gjen se tërheqjet e kursimeve nga fondi pensional kanë ndikuar në rritjen e çmimeve në treg, ku si rrjedhojë janë shkaktuar edhe dëme tjera zinxhirore, sikurse përshtatja e normave të kredive për inflacion. Rrjedhimisht, shpenzime më të larta të jetesës për qytetarët.¹⁶

¹² Agjencia e Statistikave të Kosovës. Bruto Produkti Vendor (BPV) me Qasjen e Shpenzimeve dhe të Prodhimit, TM4 2021. Burimi: <https://bit.ly/3LlVXm>

¹³ Jo-elastike do të thotë që sasia e konsumuar mbetet e njëjtë pavarësisht ndryshimit të çmimeve

¹⁴ Microeconomics. Besako et al. Burimi: <https://bit.ly/3lQJ76Z>

¹⁵ Instituti GAP. Ndikimi i luftës në Ukrainë në ekonominë e Kosovës. Maj 2022. Burimi: <https://bit.ly/3wV0Pj6>

¹⁶ FIAP. Impact of withdrawals from Chilean pension funds on the economy and individuals.

Burimi: <https://bit.ly/39TMMSV>

Po ashtu, tërheqja e mjeteve në këtë kohë kur tregjet janë duke pasur luhajtje të mëdha, sidomos për shkak të luftës në Ukrainë, ka ndikim tjetër negativ në sigurinë financiare të qytetarëve të Kosovës. Përderisa në fund të vitit 2021 çmimi për njësi i aksionit të Trustit ishte rreth 1,722 euro, aktualisht është 1,644 euro apo rreth 4.5% më i ulët. Një llogari në Trust me rreth 4,700 njësi në fund të vitit 2021 kishte bilanc prej 8,094 euro, ndërsa një e tillë gjatë muajit maj të vitit 2022 ka bilanc prej vetëm 7,726 euro apo rreth 400 euro më pak. Ndërsa fondi i përgjithshëm nën menaxhimin e Trustit, aktualisht ka vlerë rreth 102 milionë euro më pak se në fundin e vitit 2021.

Tërheqja e mjeteve në këtë kohë ka ndikim negativ të dyfishtë. Së pari, qytetarët dëmtohen duke tërhequr më pak mjete meqë luhajtjet në treg e kanë ulur vlerën e investimeve për momentin. Së dyti, me tërheqjen e rreth 594 milionë eurove apo një të katërtës së mjeteve nën menaxhim nga Trusti, edhe sikur të kemi lëvizje pozitive në treg në pjesën e dytë të vitit, me uljen e bazës investuese do të bie edhe kthimi në investime. Gjithashtu, një luhajtje e tillë në mjetet e menaxhuara nga Trusti, ku kjo e fundit është e detyruar t'i tërheqë rreth 594 milionë euro nga investimet në tregjet jashtë Kosovës, e dëmton edhe imazhin e Trustit tek fondet ku është duke investuar. Trusti i ka të investuara mjetet tjera kryesisht në bono të thesarit në Kosovë, të cilat e kanë të përcaktuar maturitetin dhe nuk mund të tërhiqen para kohe. Edhe vetë kthimi i mjeteve të Trustit në Kosovë në rast të kalimit të këtij projektligji bart kosto në vetvete, konkretisht koston e transaksioneve bankare për transferimin e mjeteve.

Figura 3. Bilanci në Trust i një llogarie me 4,700 njësi në dy periudha të ndryshme



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Trustit

Ndërrhyrja në fondin e Trustit për herë të dytë në një kohë kaq të shkurtër i rritë gjasat dhe për ndërhyrje tjera në të ardhmen, siç ka ndodhur edhe në vende tjera, sikurse në Kili ku përveç tri tërheqjeve të lejuara nga fillimi i pandemisë COVID-19, kanë dështuar edhe dy tentime tjera në Kuvend për të lejuar runde të reja të tërheqjeve. Për më shumë, në të ardhmen, në pamundësi të destinimit të shumave të mëdha për ndonjë politikë për shkak të rregullave fiskale në fuqi në Kosovë, qeveritë mund ta shohin fondin e Trustit si burim për të rritur ndjeshëm pagat, pensionet, etj.

Përfundim

Në korrik të vitit 2020, Instituti GAP kishte tërhequr vërejtjen se lejimi i njëhershëm i tërheqjes së parakohshme të kursimeve pensionale mund të shndërrohet në precedent edhe për kriza të ardhshme.¹⁷ Ende pa u mbushur dy vite, tani kemi nismën e dytë, dhe më e madhe se ajo e para, për të lejuar qasje në kursimet pensionale të qytetarëve. Kësisoj, Kosova është duke ndjekur shembullin e Kilit, shtet i cili, që nga masat e pandemisë, ka lejuar tri herë tërheqjen e kursimeve pensionale.

Tërheqja e parakohshme e mjeteve nga Trusti, në thelb, është në kundërshtim me Ligjin për fondet pensionale të Kosovës dhe funksionet e sistemit pensional. Në të kaluarën, për shkak të kufizimeve ligjore, Trusti ka refuzuar kërkesat individuale të kontributdhënësve për tërheqjen e parakohshme të kursimeve të tyre për shkaqe shëndetësore apo vështirësi tjera.

Në rast se Kuvendi i Kosovës aprovon ligjin i cili ua lejon qytetarëve tërheqjen e deri të 30% të kursimeve pensionale, Trusti obligohet që të mobilizojë tërheqjen e 594 milionë eurove nga tregjet ku janë të investuara kursimet e qytetarëve. Nëse llogaritet edhe shuma e tërheqjes së parë në periudhën dhjetor 2020-prill 2021, atëherë në total do të tërhiqen parakohe 792 milionë euro. Kjo do të dëmtonte kredibilitetin e Trustit, ngase do të ja vështirësonte investimet në të ardhmen, rrjedhimisht do të rrezikohej edhe më shumë siguria financiare e qytetarëve të Kosovës.

Për të përballuar krizën me çmime, Instituti GAP e sheh të rëndësishme që qeveria të vazhdojë adaptimin e politikave të cilat zbusin krizën. Në këtë pikë, rritja e pagës minimale, që i prek qytetarët me të hyra më të ulëta, është po ashtu një nga masat adekuate të veprimit të qeverisë. Po ashtu, duhet sa më parë që të reformohet Skema e Ndhmës Sociale, ngase kriteret aktuale ligjore se kush mund të përfitojë nga kjo skemë lënë shumë familje të varfëra jashtë skemës, kurse familjet me shumë anëtarë vazhdojnë të mbesin në varfëri edhe pas marrjes së ndihmave sociale, për shkak të shumës së vogël të subvencionimit.

¹⁷ Instituti GAP. Dilema 10% – përfitime dhe dëmet nga tërheqja e parakohshme e kursimeve pensionale. Korrik 2021. Burimi: <https://bit.ly/3wM35u6>

Aneks: Mesatarja e shumës së lejuar për tërheqje sipas projektligjit të propozuar, 2022

% e propozuar për tërheqje sipas Projektligjit	Balanci nga	Nr. i kontribuesve	Si % e totalit të kontribuesve	Total balanci (€)	Shuma e tërhequr nga tërheqja e propozuar (€)	Mesatarja e tërhequr për kontribues (€)
30%	0-1000	337,788	48.6%	108,618,000	32,585,400	96.47
	1001-1500	57,411	8.3%	70,979,000	21,293,700	370.90
	1501-2000	40,955	5.9%	71,217,000	21,365,100	521.67
	2001-2500	32,071	4.6%	71,842,000	21,552,600	672.03
	2501-3000	25,544	3.7%	69,976,000	20,992,800	821.83
	3001-3500	21,327	3.1%	69,167,000	20,750,100	972.95
	3501-4000	17,140	2.5%	64,097,000	19,229,100	1,121.88
	4001-4500	14,014	2.0%	59,455,000	17,836,500	1,272.76
	4501-5000	11,681	1.7%	55,390,000	16,617,000	1,422.57
	5001-6000	18,670	2.7%	102,355,000	30,706,500	1,644.70
	6001-7000	15,400	2.2%	99,534,000	29,860,200	1,938.97
	7001-8000	12,762	1.8%	95,619,000	28,685,700	2,247.74
	8001-9000	11,936	1.7%	101,401,000	30,420,300	2,548.62
	9001-10000	11,920	1.7%	113,196,000	33,958,800	2,848.89
25%	10001-11000	13,340	1.9%	139,573,000	34,893,250	2,615.69
	11001-12000	8,409	1.2%	96,657,000	24,164,250	2,873.62
	12001-13000	7,107	1.0%	88,839,000	22,209,750	3,125.05
	13001-14000	5,669	0.8%	76,262,000	19,065,500	3,363.12
	14001-15000	4,082	0.6%	59,098,000	14,774,500	3,619.43
	15001-20000	12,603	1.8%	216,074,000	54,018,500	4,286.16
20%	20001-25000	5,786	0.8%	128,513,000	25,702,600	4,442.21
	25001-30000	3,599	0.5%	98,376,000	19,675,200	5,466.85
15%	30001-35000	2,210	0.3%	71,539,000	10,730,850	4,855.59
	35001-40000	1,399	0.2%	52,278,000	7,841,700	5,605.22
10%	40001+	2,700	0.4%	152,531,000	15,253,100	5,649.30
Total		695,523	100.0%	2,332,586,000	594,183,000	

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Trustit



Funded by
the European Union

Projekti "Inovacioni për mediat e
qëndrueshme dhe angazhimin qytetar"
i financuar nga BE, implementohet nga:

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

KOSOVO 2.0

**Ndikimi i tërheqjes së kursimeve
pensionale deri në 30%**
në ekonominë e Kosovës